

## Komuna e Deçanit/Deçani

### **Slobodan (Dušan) Prašević**

(3.12.1945, serb nga Vraniqi/Vranić, komuna e Gjakovës/Đakovica, pensionist)

Slobodani ishte komandant i stacionit policor në Irzniq/Rznić, përpara se të shkonte në pension. Në datën **2.02.1998**, rreth orës 15:30 - 16:00, përderisa me veturë po kalonte nëpër fshatin **Ratish i Ulët/Donji Ratiš**, ndaj tij u hap zjarr me breshëri. Slobodani u plagos. Në gjendje të rëndë, ai u transferua në spitalin e Prishtinës/Priština, ku së shpejti ndërroi jetë nga plagët vdekjeprurëse.

**Burimet:** deklarata R.V, FDH-12128; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički.*, III,904; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; Z. Stijović, *Kosmet...*, 104; *Napetost na svakom koraku*, Naša Borba, 4.3.1998, FDH-30898; *Pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme – viktimat e terrorizmit shqiptar në vitin 1998*, na <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html> , FDH-31078.

### **Shkëlzen (Jahë) Pepshi**

(20.10.1969, shqiptar nga Juniku/Junik, komuna e Deçanit/Deçani, vozitës, dy fëmijë)

Shkëlzeni jetonte së bashku me bashkëshorten, dy fëmijë dhe të ëmën në fshatin Junik. Nga **mesi i muajit mars të vitit 1998**, para shtëpisë së tij erdhën katër policë me dy vetura zyrtare të tipit *Niva*. Djali i axhës së Shkëlzenit, Qamili, ka vërejtur se policët kanë hyrë në shtëpinë e Shkëlzenit dhe, disa minuta më pas, dolën me të. Shkëlzeni i kishte duart e lidhura pas shpine. Hipën në veturat dhe shkuan në drejtim të qendrës së **Junikut/Junik**. Askush nga familjarët nuk pati gu-

xim të shkonte më vonë në polici dhe të pyeste për fatin e Shkëlzenit. Shumë shpejt pas arrestimit të tij, e ëma, bashkëshortja dhe fëmijët e tij u larguan nga vendi dhe shkuan në Zvicër, te vëllezërit e Shkëlzenit. Në fshat u kthyen vetëm pas përfundimit të luftës, por për një kohë të gjatë nuk dinin asgjë për fatin e Shkëlzenit. Në muajin mars të vitit 2005, Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur e ka njoftuar familjen Pepshi për zbulimin e mbetjeve mortore të familjarit të tyre. Vëllezërit e Shkëlzenit shkuan në morgun e Rahovecit/Orahovac më 23.03.2005, për të marrë mbetjet mortore të të vëllait dhe, po atë ditë, i varrosën ato në varrezat e Junikut/Junik.

**Burimi:** deklarata S.T, FDH-19236.

### **Gazmend (Hysen) Mehmetaj**

(7.02.1978, shqiptar nga Gllogjani/Glodane, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

### **Agron (Niman) Mehmetaj**

(2.11.1978, shqiptar nga Gllogjani/Glodane, komuna e Deçanit/Deçani, student, pjesëtar i UÇK-së)

### **Himë (Rasim) Haradinaj**

(10.08.1981, shqiptar nga Gllogjani/Glodane, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Gazmendi u bë pjesëtar i UÇK-së më 1.06.1996, përderisa ajo vepronte në ilegallitet. Njësitë i tij ishte aktiv në sigurimin e armatimeve për UÇK-në.

Agroni i ka ndërprerë studimet në Prishtinë/Priština në shkurt të vitit 1998, për tu bërë pjesëtar i UÇK-së në fshatin Gllogjan/Glodane.